

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KALO & ASSOCIATES" SHPK



Sot, më datë 25 Mars 2005, në Tiranë, në mbështetje të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", ne, **Përparim Kalo**, shtetas shqiptar, lindur në Kuçovë, më 12 Dhjetor 1957, mbajtës i pasaportës nr. Z0116065, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, dhe **Alban Çaushi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25 Mars 1973, mbajtës i pasaportës nr. 0916041, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnetin tonë të plotë dhe të lirë vendosëm të krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "KALO & ASSOCIATES" SHPK, Akti i themelimit të së cilës hartohet me këto kushte:

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria do të ketë emrin "KALO & ASSOCIATES" SHPK.

Neni 2
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 3
Forma ligjore

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar, por mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

A large, stylized handwritten signature in black ink, consisting of a large loop followed by a series of smaller, connected strokes.

A smaller, more compact handwritten signature in black ink, appearing as a series of quick, connected strokes.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afat i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 5

Selia

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga e Kavajës n. 59, Tërana Tower, Kat V, Tiranë, Shqipëri.

5.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë ofrimi i shërbimeve ligjore në fushën civile dhe penale, personave fizikë dhe juridikë, shqiptarë apo të huaj, përgatitja e dokumentacionit ligjor, përfaqësimi në gjykatë dhe në organe të tjera shtetërore.

6.2 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (një qind mijë) lekë.

7.2 Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 1.000 (një mijë) kuota, me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë secila. Secili nga ortakët do të zotërojë përkatësisht:

- a) Përparim Kalo zotëron 95 % (nëntëdhjetë e pesë) për qind të të gjithë kapitalit;
- b) Alban Çaushti zotëron 5% (pesë) për qind të pjesëve të kapitalit.

7.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer nga ortakët e shoqërisë.



Neni 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit

Secili nga ortakët ka të drejtë të transferojë pjesët e tij të kapitalit në përputhje me Statutin e Shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 10

Asambleja e ortakëve

Asambleja e ortakëve merr vendime sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë.

Neni 11

Administratori

11.1 Shoqëria ka një administrator i cili do të jetë Përparim Kalo. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen në Statut.

11.2 Administratori emërohet, zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë në përputhje me kërkesat e Statutit.

Neni 12

Kontrolli financiar


Shoqëria mund të caktojë ekspert kontabël për kontrollin financiar të saj.

Neni 13

Viti financiar

13.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti.

13.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe përfundon më 31 Dhjetor 2005.



Neni 14
Dividendi

Shoqëria do t'i shpërndajë ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të ketë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe detyrimet për mbajtjen e rezervave të domosdoshme dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Neni 15
Likuidimi


Likuidimi i Shoqërisë vendoset nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me kërkesat e Statutit.

Neni 16
Dispozita mbyllëse

Ky Akt themelimi hartohet në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe më fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË:

Përparim Kalo


Alban Çaushti


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 322 Rep.

37 kod.

VËRTETIM

Sot, më datë 29.03 2005, para meje Lumë Almy notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Përparim Kalo, shtetas shqiptar, lindur në Kuçovë, më 12 Dhjetor 1957, mbajtës i pasaportës nr. Z0116065, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, dhe Alban Çausi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25 mars 1973, mbajtës i pasaportës nr. 0916041, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët më deklaruan se sa më sipër është Akti i themelimit të Shoqërisë "Kalo & Associates" Shpk, hartuar me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë dhe në përputhje me legjislacionin tregtar. Unë noterja, pasi e lexova tekstin e këtij akti me zë të lartë dhe ortakët e nënshkruan atë para meje, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.



NOTERE

Lumë Almy
[Signature]